



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 299 Prot.  
2024

Tiranë, më 14 . 02 .

**V E N D I M**

**Nr. 48 , Datë 14 . 02 . 2024**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja b), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar<sup>1</sup>, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup> mori në shqyrtim ankesën me nr. 159 Regj., datë 21.08.2023, paraqitur nga shtetasja D. D. B, kundër Drejtorisë Vendore Shkodër, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “racës<sup>3</sup>”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I :**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Në parashtrimet e sjella pranë Komisionerit, subjekti ankues, D. B, informon Komisionerin lidhur me problematikën e saj, për të cilën shprehet se:

*“Unë jam pjesë e komunitetit egjiptian dhe në vitin 2008 më është djegur shtëpia, e cila për shkak të pamundësisë për ta rregulluar, ka mbetur në atë gjendje deri në vitin 2017, kur në sajë të disa donacioneve të ndryshme nga shoqata dhe qytetarë, jam ndihmuar lidhur me rindërtimin e saj, pasi kishim marrë leje edhe në Bashkinë Shkodër.*

*Pas rikonstruksionit të banesës kam aplikuar për legalizimin e rindërtimit, pasi edhe shtëpia ekzistuese ka qenë një shtesë e shtëpisë së vjehrrit tim. Kam aplikuar dhe jam interesuar vazhdimisht tek Kadastra<sup>4</sup>, dhe më është kthyer përgjigjja se kërkesa ime ende nuk është shqyrtuar.*

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

<sup>3</sup> Ankuesja vetëdeklarohet se i përket pakicës kombëtare egjiptiane.

<sup>4</sup> Citim i ankueses referuar DV ASHK Shkodër.

*Në përgjigjen e fundit që më kanë kthyer, ata më informojnë se nuk rezulton se unë kam aplikuar. Kërkoj që kërkesat e mijë të trajtohen me seriozitet, pasi ndihem e papërfillur për shkak të racës, si pjesë e komunitetit egjiptian. Dua të më jepet një informacion i saktë lidhur me aplikimin tim në këtë institucion për legalizimin e shtëpisë time. Ato i japin legalizimet sipas preferencave dhe për ne që jemi komunitet i anashkalojnë dhe madje na thonë edhe që nuk figurojmë që kemi aplikuar”.*

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të konstatojë diskriminim të saj nga ana e DVASHK Shkodër, për shkak të racës, si dhe dhe të merren masa për legalizimin e banesës së saj.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se:

*“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Neni 7 i LMD-së, i ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.”

Bazuar në nenin 32/1/b të Ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar në nenin 32, pika 2 dhe 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 962/1 prot., datë 23.08.2023, Komisioneri ka njoftuar dhe i ka kërkuar parashtrime e dokumentacion provues<sup>5</sup>, subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa, DV ASHK Shkodër , lidhur me pretendimin e subjektit ankues.

---

<sup>5</sup>Respektivisht është kërkuar:

*“Informacion në lidhje me problematikën e pretendimet e paraqitura nga subjekti ankues.*

*Kopje të praktikës së plotë/procedurës së ndjekur nga ana juaj, lidhur me kërkesën për legalizim banese të subjektit ankues Davë Demir Bregu<sup>5</sup>.*

- Njëpërmjet shkresës me nr. 2753/1 prot., datë 29.08.2023, Komisioneri është njohur me qëndrimin institucional të DV ASHK Shkodër, përsa i takon problematikës së ankueses, shkresë në të cilën, ndër të tjera, citohet se:

*“...nga verifikimi i kryer nga DV ASHK Shkodër, rezulton se subjekti ka dorëzuar aplikim për legalizim me nr. prot. 1190, datë 20.11.2017, i cili nuk figuron në sistemin e vetëdeklarimeve. Subjekti duhet të aplikojë për legalizimin e objektit informal në sistemin e-albania, pasi formati i dërguar prej këtij subjekti nuk është i vlefshëm për alikimet e reja.”*

2. Në vijim të kërkesës për dokumentacion provues lidhur me pretendimin e ankueses, Komisioneri, njëpërmjet shkresës me nr. 962/3 prot., datë 27.09.2023, ka kërkuar sërish nga DV ASHK Shkodër, për të plotësuar sa është kërkuar prej tij.
- Me shkresën me nr. 3476/1 prot., datë 10.10.2023, DV ASHK Shkodër, ka dërguar sërish të njëjtin informacion, (të pashoqëruar me dokumentacionin e kërkuar apo informacion për mospasjen e tij), duke cituar se:

*“... aplikimi i znj. D. B nuk figuron në sistemin e vetëdeklarimeve. Ndodhur në këto kushte, në mbështetje të ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, nuk mund të vazhdojmë procedurat e mëtejshme derisa aplikimi të përfshihet në sistem.”*

3. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, njëpërmjet shkresës me nr. 962/5 prot., datë 07.11.2023, njoftoi dhe ftoi palët<sup>6</sup> për pjesëmarrje në seancë dëgjimore, pranë Zyrës së Komisionerit.

Palëve iu është bërë e ditur se kanë të drejtë të depozitojnë në cilësi prove çdo informacion plotësues ose akt administrativ, të cilin ende nuk e kanë paraqitur pranë KMD-së dhe që vlerësohet se ka rëndësi për përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave të çështjes.

Gjithashtu është kërkuar të depozitohet gjatë seancës:

- Kopje e praktikës së depozituar nga ankuesja në vitin 2017 për legalizimin e banesës së saj. (kërkesë dhe dokumentacion i dorëzuar prej saj)

---

*Informacion lidhur me statusin juridik të objektit banesë të subjektit ankues.*

*Informacion lidhur me statusin juridik të banesave kufitare ose në të njëjtën zonë/lagje me subjektin ankues: sa prej tyre janë të legalizuara, sa në proces legalizimi apo staturë të tjera juridike e faktike të tyre, nëse disponohen të dhëna.*

*Cilat janë masat e ndërmarra prej jush për verifikimin e zgjidhjen e ankesës së znj. D. D. B? Kopje të akteve shkresore.*

*Si dhe çdo informacion ose dokumentacion tjetër që mendoni se i shërben sqarimit të çështjes.”*

<sup>6</sup> Komisioneri ka përfshirë kryesisht edhe ASHK, si subjekt që mund të ndihmojë në sqarimin e kësaj çështjeje dhe procedurave që ndiqen nga ASHK dhe DV ASHK-të.

---

Adresa: Rruga “Durrësit”, Nr. 27, Kodri Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al), Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

- Cilat janë mangësitë e konstatuara në praktikën e depozituar nga ankuesja, si dhe kopje te akteve me të cilat ajo është vënë në dijeni të mangësive në dokumentacion, nëse ka patur të tilla.
  - Sa është numri i kërkesave/praktikave për legalizim të dorëzuara në vitin 2017, si dhe si ka vijuar ecuria e tyre deri aktualisht? (statistika e të dhëna të tjera, nëse dispononi)
  - Cila është baza ligjore (si dhe praktika e ndjekur) mbi të cilën vijon shqyrtimi i praktikave/kërkesave të depozituara pranë institucionit tuaj, aktualisht (2023), lidhur me aplikimet e bëra nga qytetarët për legalizimin e banesave të tyre që në vitin 2017?
  - Si dhe çdo informacion e të dhënë tjetër, që vlerësohet se ndihmon në sqarimin e problematikës së ankueses D. B.
4. Referuar procesverbalit të mbajtur me datë 22.11.2023, nga punonjësit e Zyrës së KMD-së, rezulton se asnjëra nga palët e njoftuara nuk ishin të pranishëm në seancën dëgjimore të njoftuar paraprakisht.

Subjekti ankues ka njoftuar punonjësen e Zyrës Rajonale të KMD (Shkodër) se ishte në pamundësi për t'u paraqitur për arsye familjare.

Ndërsa, nga biseda në telefon, DV ASHK Shkoder (ditën e seancës, me datë 22.11.2023), njoftoi se ishin në pamundësi për t'u paraqitur (evidentojmë faktin se, nuk kanë lajmëruar KMD-në, brenda afatit 48 orë nga data e komunikuar për zhvillimin e seancës). Nga ana e inspektorit të çështjes iu bë e ditur se, në përmbushje të kërkesave të Komisionerit, mund të dërgonin parashtrimet dhe dokumentacionin përkatës, në ditët në vijim.

5. Në vijim të seancës dëgjimore, me shkresën me nr. 4393/1 prot., datë 07.12.2023, DV ASHK Shodër, dërgoi informacionin si më poshtë vijon:

*“Pas marrjes dijeni të ankesës dhe verifikimeve në Sektorin e Legalizimeve, rezulton se, subjekti ka dorëzuar një formular aplikimi për legalizim, me numër protokolli hyrës 1190, datë 20.11.2017, sipas ligjit të vjetër për legalizim, ligjit me nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, dhe me anë të disa shkresave, ju kemi informuar se aplikimi i znj. B, nuk figuron në Sistemin e Vetëdeklarimeve.*

*Nisur nga shkresat tuaja, janë marrë masat për verifikimin në terren të objektit të vetëdeklarueses, znj. B, me anë të akt-evidentimit të datës 23.11.2023.*

*Sipas ligjit nr. 20/2020, neni 17, pika 1 “Fusha e zbatimit dhe evidentimi i ndërtimeve pa leje”, 1. Procedurat, sipas këtij seksioni, zbatohen për ndërtimet pa leje që ASHK-ja konsideron në ortofoton e realizuar për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, nga autoriteti shtetëror përgjegjës për informacionin gjeohapësinor, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.*

*Pra, duhet t'i referohemi produkteve të ortoimazherisë, me emërtesat “ortofoto 2015” ASIG.*

Referuar nenit 69, pika 9, ndërtimet pa leje, që janë përfunduar në strukturë përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, ndonëse nuk evidentohen në ortofoton, sipas pikës 1, të nenit 17, të tij, trajtohen nga ASHK-ja, sipas rregullave të seksionit I, të Kreut III, nëse janë:

- a) Objekte, shtesa pa leje në ndërtim të regjistruar, objekte me shkelje të lejes së ndërtimit, me funksion banimi ose në funksion të aktivitetit bujqësor apo blegtoral, ndërtuar në fshat;
- b) Objekte me shkelje të lejes së ndërtimit apo shtesa në ndërtime të regjistruara, nëse për to nuk është vendosur më parë prishja apo konfiskimi, sipas ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, ose këto dënime janë parashkruar sipas nenit 46, të ligjit nr. 10279/2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

Për sa më sipër, DV ASHK Shkodër, në mbështetje të ligjit nr. 20/2020 “Për perfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, nenit 17, pika 1, nenit 69, pika 9, gjithashtu VKM nr. 1178, datë 24.12.2020, pas azhurnimit të objektit nga grupi i terrenit, rezulton se, sipas imazheve satelitore dhe ajrore të përdorimit të përgjithshëm, objekti deri në vitin 2017, nuk ka mbulesë e as funksion. Bashkëlidhur imazhet satelitore 2015-2023.”

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe të pafavorshëm të ankueses nga ana e DV ASHK Shkodër.**

Bazuar në parashtrimet, kronologjinë e ngjarjeve dhe dokumentacionin e depozituar nga palët në këtë proces, Komisioneri vëren se:

Në bazë të ligjit nr.20/2020 “Për perfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr.20/2020) ASHK është institucioni përgjegjës për ofrimin e shërbimit publik, me qëllim përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë, përfshirë aplikimet për legalizim të objekteve pa leje.

Vendimi Nr. 1178, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e dokumentacionit dhe të rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimit pa leje”, përcakton dokumentacionin dhe rregullat e hollësishme për evidentimin e ndërtimeve pa leje dhe procedurën për trajtimin e tyre nga ASHK-ja.

Subjekti ankues nëpërmjet formularit të aplikimit për legalizim me nr. 1190 prot., datë 20.11.2017, ka aplikuar për përfshirjen në proces legalizimi të banesës së saj, ndërtim pa leje (sipas deklaramentit të ankueses, shtesë në objektin ekzistues në pronësi të vjehrrit të saj), pranë DV ASHK Shkodër.

Nga këqyrja e dokumentacionit evidentohet se ka patur një korrespondencë shkresore mes ankueses dhe këtij insitucioni, të cilit ajo i është drejtuar në vijimësi, përgjatë viteve 2019-

2023, lidhur me kërkesën për t'u pajisur me vërtetim për përfshirjen e banesës së saj në proces legalizimi.

- Përsa i takon pretendimeve që lidhen me periudhën kohore të shtrirë në vitet 2019-2020, gjatë së cilës ankuesja ka paraqitur kërkesa vijuese pranë DV ASHK Shkodër, Komisioneri vlerëson se ato nuk duhet t'i nënshtrohen analizës së tij, pasi janë jashtë afatit të pranueshmërisë së tyre, sipas parashikimeve të LMD-së.

Sikurse rezulton nga citimi i akteve respektive<sup>7</sup>, drejtuar subjektit ankues në vitet 2019 dhe 2020, DV ASHK Shkodër ka informuar atë se, kërkesa e saj për përfshirjen e banesës në proces legalizimi është administruar prej tyre dhe do shqyrtohet bazuar në VKM nr. 634, datë 07.09.2016, pasi të zbatohen etapat procedurale. Ankueses i bëhet me dije se: *“Ankesa juaj është akoma e pashqyrtuar dhe praktika është e papërfshirë në sistem.”*

Në kontekst të sa mësipër, ankuesja ka paraqitur kërkesat e saj pranë DV ASHK Shkodër (*fakt për të cilin dhe pretendon diskriminimin*), gjatë vitit 2019 dhe 2020. Njëherësh është njohur me përgjigjet e këtij subjekti, gjatë 2019 dhe 2020. Ankesa pranë KMD-së është regjistruar në datën 21.08.2023, pra më vonë se dy vite nga marrja dijani.

Për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, shkronja dh), të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, i cili citon se: *“Ankesa nuk prahohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijani për sjelljen diskriminuese”*, ankesa që lidhet me pretendimet që burojnë nga veprimi a mosveprimi i DV ASHK Shkodër gjatë kësaj periudhe kohore, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë së janë tejkualuar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

- Përsa i takon pretendimeve të ankueses kundrejt DV ASHK Shkodër, për veprimet e mosveprimet e kësaj të fundit, lidhur me kërkesat/ankesat e saj paraqitur gjatë vitit 2023<sup>8</sup>, për vijimin e procedurave të mëtejshme për legalizimin e banesës së saj, Komisioneri analizon si më poshtë vijon:
  - Ankuesja i është drejtuar shkresërisht (shkresë që mban nr. 272 prot., datë 13.01.2023) DV ASHK Shkodër, lidhur me kërkesën e saj lidhur vërtetimin për vijimin e procedurave të mëtejshme për legalizimin e banesës së saj.

---

<sup>7</sup> Shkresë me nr. 4732/14 prot., datë 08.08.2019, me nr. 8398/6 prot., datë 14.08.2020, me nr. 8798/9 prot., datë 27.08.2020, të DV ASHK Shkodër.

<sup>8</sup> Kërkesës të ankueses me nr. 272 prot., datë 13.01.2023.

Nga këqyrja e dokumentacionit dhe akteve të depozituara, pranë KMD-së, (si dhe nga përgjigjet drejtuar KMD-së dhe ankueses<sup>9</sup> nga DV ASHK Shkodër) rezulton se, DV ASHK-ja pohon, ndër të tjera, se:

- Ankuesja ka dorëzuar formularin e aplikimit që në datën 20.11.2017 (me nr. 1190 prot.);
- Aplikimi i ankueses nuk figuron në sistemin e vetëdeklarimeve;
- Nga ana e tyre, nuk mund të vijohet me procedurat e mëtejshme, derisa aplikimi të përfshihet në sistem, sipas parashikimeve të ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare në Republikën e Shqipërisë”;
- Ankuesja duhet të aplikojë për legalizim të objektit informal në sistemin e-Albania, pasi formati që ajo ka dorëzuar nuk është i vlefshëm për aplikimet e reja.
- Referuar citimit të DV ASHK Shkodër (pasi akti shkresor nuk është depozituar në cilësi prove pranë KMD-së), bazuar në akt-evidentimin e datës 23.11.2023, rezulton se punonjësit e saj kanë realizuar verifikimin në terren të objektit të znj. D. B, dhe, pas azhurnimit të objektit nga grupi i terrenit rezulton gjithashtu se, sipas imazheve satelitore dhe ajrore të përdorimit të përgjithshëm, objekti deri në vitin 2017 nuk ka mbulesë e as funksion (referuar imazheve satelitore 2015-2013).
- Deklarimi se objekti deri në vitin 2017, sipas imazheve satelitore, nuk ka mbulesë e as funksion është në përputhshëmi me deklaratimet e ankueses se shtëpia ishte djegur në vitin 2008, pra para vitit 2015 (periudha kur figurojnë dhe imazhet e para satelitore-viti 2015) dhe se vetëm në 2017 është bërë i mundur rindërtimi i saj. (fakt i pasqyruar më pas në imazhet satelitore të 2023).

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri analizon, *së pari*, legjislacionin të cilit i nënshtrohet rasti në fjalë dhe sipas të cilit duhet shqyrtuar pretendimi i ankueses, përsa i takon orientimit të znj. B nga ana e DV ASHK Shkodër, lidhur me faktin se ajo, fillimisht duhet të bëjë kërkesë për legalizim objekti informal në sistemin e-Albania, dhe më tej mund të vijohet me hapat e tjerë proceduralë.

Përcaktimi i procedurave dhe organit shtetëror përgjegjës për përfundimin e proceseve kalimtare administrativo-ligjore, të regjistrimit të titujve të pronësisë për pasuritë e paluajtshme në pronësi private në Republikën e Shqipërisë, është objekt i ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

Pretendimet e kërkitimit subjektivit ankues lidhen me procedurën për legalizimin e objektit informal/ banesës së saj, dhe për rrjedhojë, i nënshtrohen përcaktimeve të këtij ligji dhe akteve nënligjore të dala *në* dhe *për* zbatimin e tij.

Sipas ligjit 20/2020, në nenin 17, pika 1, të tij “Fusha e zbatimit dhe evidentimit të ndërtimeve pa leje”, përcakton se:

---

<sup>9</sup> Shkresat me nr. 2753/1 prot., datë 29.08.2023, me nr. 3476/1 prot., datë 10.10.2023 dhe me nr. 4393/1 prot., datë 07.12.2023, të DV ASHK Shkodër.

“1. Procedurat, sipas këtij seksioni, zbatohen për ndërtimet pa leje që ASHK-ja konstaton në ortofoton e realizuar për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, nga autoriteti shtetëror përgjegjës për informacionin gjeohapësinor, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Ndërtimet pa leje, për të cilat poseduesit nuk kanë aplikuar për legalizim deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, trajtohen nga ASHK-ja, kryesisht, gjatë proceseve të regjistrimit fillestar ose përmirësimit të zonës kadastrale apo nëpërmjet procedurës së evidentimit të ndërtimeve pa leje.

3. Evidentimi i ndërtimeve pa leje kryhet nga ASHK-ja, nëpërmjet përditësimit të gjendjes ndërtimore në terren, duke pasqyruar edhe funksionin e ndërtimit.

4. Për ndërtimet pa leje, që futen në kategorinë e objekteve me shkelje të lejes së ndërtimit, krahas përditësimit të gjendjes ndërtimore në terren, ASHK-ja administron edhe dokumentacionin e lejes së ndërtimit.

5. Nëse poseduesi i ndërtimit pa leje, me veprime konkrete, nuk lejon punonjësit e ASHK-së të kryejnë përditësimin e gjendjes ndërtimore në terren, ASHK-ja vendos pezullimin e ndërtimit nga legalizimi. Procesi rifillon pas krijimit të kushteve për evidentim nga poseduesi.

6. Dokumentacioni dhe rregullat e hollësishme të evidentimit të ndërtimeve pa leje përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 69 “Rregullat kalimtare për procedurat e legalizimit”

1. Aplikimet për legalizim, të administruara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, që kanë mangësi të elementeve të formës, konsiderohen të vlefshme.

.....

9. Ndërtimet pa leje, që janë përfunduar në strukturë përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, ndonëse nuk evidentohen në ortofoton, sipas pikës 1, të nenit 17, të tij, trajtohen nga ASHKja, sipas rregullave të seksionit I të kreut III, nëse janë:

a) objekte, shtesa pa leje në ndërtim të regjistruar, objekte me shkelje të lejes së ndërtimit, me funksion banimi ose në funksion të aktivitetit bujqësor apo blegtoral, ndërtuar në fshat...

Rregullat për zbatimin e kësaj pike dhe evidentimin e ndërtimeve pa leje përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

VKM nr. 1178, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e dokumentacionit dhe të rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimit pa leje”, ka për qëllim përcaktimin e dokumentacionit dhe të rregullave të hollësishme për evidentimin e ndërtimeve pa leje, bazuar në një proces të ndarë në dy etapa<sup>10</sup>:

a) evidentimin në terren të gjendjes ndërtimore;

b) evidentimin e faktit nëse ndërtimi përfshihet në fushën e zbatimit të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, në përputhje me nenet 17, pika 1, dhe 69, pika 9, të tij.

<sup>10</sup> Pika 1, e tij.



Kjo VKM, në pjesën III, të saj “Evidentimi i përfshirjes së ndërtimit pa leje, në fushën e zbatimit të ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, përcakton se:

“12. Për ndërtimin pa leje që nuk është aplikuar më parë për legalizim aplikohet, nëpërmjet platformës unike qeveritare e-Albania, kundrejt tarifës së aplikimit prej 3 000 (tre mijë) lekësh. Formulari i kërkesës për legalizim është sipas aneksit 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

13. Gjatë procesit të evidentimit në terren të bllokut kadastral/ndërtimit, drejtorja vendore e ASHK-së evidenton edhe nëse ai përfshihet ose jo në fushën e zbatimit të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë, në Republikën e Shqipërisë”, sipas neneve 17, pika 1, dhe 69, pika 9.

14. Ndërtimet pa leje, që janë të pranishëm në ortofoton e realizuar për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, nga autoriteti shtetëror përgjegjës për informacionin gjeohapësinor, janë të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit të sipërpërmendur, në përputhje me pikën 1, të nenit 17, pavarësisht llojit, funksionit apo vendndodhjes së tyre. Verifikimi për praninë e tyre në ortofoto kryhet nëpërmjet Gjeoportalit të krijuar e të administruar nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, duke iu referuar produkteve të ortoimazherisë, me emërtesat “ortofoto 2015”, në vijim, “ortofoto”.

Nëse nga evidentimi në terren rezulton se ndërtimi ka ndryshime të sipërfaqes, shtesa apo ndryshime të konfigurimit, në raport me gjendjen e pasqyruar në “ortofoto”, atëherë i gjithë ndërtimi konsiderohet i përfshirë në fushën e zbatimit të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, bashkë me shtesat, sipas gjendjes faktike të evidentuar në terren.

15. Ndërtimet që nuk gjenden në “ortofoto” përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, nëse, në përputhje me pikën 9, të nenit 69, plotësojnë njëkohësisht këto kushte:

a) janë ngritur në strukturë përpara datës 07.05.2020, ku “struktura” është tërësia e elementeve horizontale dhe vertikale mbajtëse, përfshirë edhe sistemin e lidhjes me tokën dhe mbulesën;

b) për to nuk është vendosur më parë prishja apo konfiskimi, sipas ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, ose këto dënime janë parashkruar, shfuqizuar, anuluar, konstatuar të pavlefshme, në rrugë administrative ose gjyqësore. Këtij kushti, si rregull, i nënshtrohen vetëm “objektet me shkelje të lejes së ndërtimit” dhe “shtesat në ndërtime të regjistruara”. Ndërtimet pa leje të llojit “objekt” përfshihen në fushën e zbatimit, pavarësisht sanksioneve të mësipërme, nëse ato nuk janë ekzekutuar deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, dhe nuk janë vendosur ose lënë në fuqi me vendim gjyqësor të formës së prerë. Dokumentacioni provues, sipas kësaj shkronje, administrohet, sipas rastit,

nga autoritetet përgjegjëse të inspektimit ose/dhe autoritetet e zhvillimit dhe kontrollit të territorit.

16. Për të konstatuar nëse ndërtimi pa leje është ndërtuar në strukturë përpara datës 07.05.2020, drejtoritë vendore të ASHK-së mbështeten, në:

a) ortofotot e publikuara në Gjeoportali për pjesët e territorit të Republikës së Shqipërisë që ato pasqyrojnë;

b) imazhet satelitore ose ajrore të përdorimit të përgjithshëm, sipas kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara nga subjektet disponuese;

c) planrilevimet, si dokumentacion hartografik i hartuar në kuadër të regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme, të administruara nga ASHK-ja;

ç) vendime gjyqësore për vërtetim të faktit se ndërtimi është ngritur para datës 07.05.2020 ose çdo vendim tjetër gjyqësor që e provon këtë fakt;

d) aktekspertiza nga një grup prej të paktën 3 (tre) ekspertësh, inxhinierë të licencuar, që të përcaktojnë periudhën e ngritjes dhe vjetërsinë e ndërtimit;

dh) dokumente të tjera zyrtare, juridikisht të vlefshme, që provojnë ekzistencën e ndërtimit pa leje në momentin kohor të dhënë, në një datë dhe vend të caktuar.

Dokumentacioni, që provon periudhën në të cilën është ngritur ndërtimi pa leje, administrohet në praktikën dokumentare të legalizimit të ndërtimit pa leje. Barrën e provës për rastet e parashikuara në shkronjat “c” deri në “d”, të kësaj pike, e ka poseduesi i ndërtimit pa leje.”

Në pjesën IV “Dispozita kalimtare dhe të fundit”, në pikën 21, të kësaj VKM me nr. 1178, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e dokumentacionit dhe të rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimit pa leje”, përcaktohet se:

“21. Subjektet, që kanë bërë kërkesë për legalizim nga data 07.05.2020 deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi dhe për të cilat nuk është miratuar vendimi për legalizim, duhet të shlyejnë tarifën e aplikimit të parashikuar në pikën 12 të tij.”

Bazuar në sa më sipër, si dhe në deklaratimet e pohimet e DV ASHK Shkodër, rezulton se, pavarësisht faktit se, objekti ndërtimor/banesa e subjektit ankues-objekt gjykimi pranë KMD-së, sipas imazheve satelitore dhe ajrore të produkteve të ortoimazherisë “Ortofoto 2015” ASIG, rezulton objekt pa mbulesë dhe funksion, në 2015-ën, dhe në kushtet kur banesa është ndërtuar në 2017-ën, ndërtim pa leje, **rasti i ankueses duhet të trajtohet nga ASHK-ja (Drejtoria Vendore Shkodër në këtë rast) sipas rregullave të seksionit të I, Kreut III, të ligjit 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe pikës 1/b, pikës 15, të VKM nr. 1178/2020 “Për përcaktimin e dokumentacionit dhe të rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimit pa leje”, në zbatim të kriterëve përkatëse të përcaktuara në to, si dhe në përputhje me frymën e tyre.**

Së dyti, Komisioneri ka vlerësuar nëse veprimet e DV ASHK Shkodër, (përsa i takon orientimit të ankueses lidhur me faktin se ajo, fillimisht duhet të bëjë kërkesë për legalizim objekti informal në sistemin e-Albania, dhe më tej mund të vijohet me hapat e tjerë proceduralë), janë në përputhje me parashikimet ligjore sa më sipër.

Nisur nga analiza e fakteve, rrethanave dhe provave të depozituara, Komisioneri vlerëson se, veprimet e DV ASHK Shkodër kundrejt ankueses, janë haptazi në kundërshtim dhe keqzbatim të dispozitave ligjore përkatëse, lidhur me kërkesën e paraqitur nga subjekti ankues për legalizim të banesës së saj (ndërtim pa leje).

Komisioneri thekson faktin se, objekt i këtij shqyrtimi është vetëm pretendimi i ankueses lidhur me faktin që nga DV ASHK Shkodër i është kërkuar të aplikojë rishtaz online për legalizim banese, në sistemin e-Albania, ndërkohë që ajo kishte aplikuar që në vitin 2017 (fakt i pranuar nga të dyja palët në proces) dhe nuk ka pse të riaplikojë kundrejt një tarife me vlerë 3 000 (tre mijë) lekë.

Për rrjedhojë Komisioneri nuk ka shqyrtuar e analizuar kriteret, rregullat, procedurat e dokumentacionin përkatës të kualifikimit për legalizimin e banesës ndërtim pa leje. Kjo pasi, këto janë hapa të tjerë proceduralë, të cilët ndiqen, zbatohen e vlerësohen nga DV ASHK-ja, pasi është ezauruar paraprakisht kërkesa për legalizim objekti informal.

Bazuar në sa më lart, ankuesja ka dorëzuar pranë DV ASHK Shkodër kërkesën për legalizim të banesës së saj (ndërtim pa leje) që në datën 20.11.2017.

DV ASHK Shkodër shprehet se znj. B ka dorëzuar aplikimin, kërkesën për legalizim objekti me nr. 1190 prot., datë 20.11.2017, por nuk figuron në sistemin e vetëdeklarimeve, dhe për rrjedhojë duhet të aplikojë për legalizim objekti informal në sistemin e-Albania, pasi formati që ajo ka dërguar (në 2017-ën) nuk është i vlefshëm për aplikimet e reja.

Në analizë të gjithë sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, DV ASHK Shkodër gabon në interpretimin e klasifikimit që i bën aplikimit, kërkesës së ankueses, duke mos ia pranuar si të vlefshme kërkesën e paraqitur në vitin 2017, dhe duke pretenduar se duhet bërë një kërkesë e re, për të cilën duhet aplikuar në sistemin online të e-Albania, kundrejt faturës prej 3 000 (tre mijë) lekësh.

Komisioneri vlerëson se, aplikimi i bërë apo kërkesa e ankueses e depozituar në vitin 2017, është e vlefshme dhe duhet konsideruar *e kryer*, de facto dhe de jure, dhe se duhet të vijohet me hapat e tjerë proceduralë nga ana e DV ASHK Shkodër, në varësi të kërkesave të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore respektive, si dhe në transparencë e nëpërmjet një komunikimi të qartë e të kuptueshëm për subjektin ankues.

Vetë dispozitat e ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, të cilit i nënshtrohet shqyrtimi i rastit në fjalë, (sipas analizës në faqet 7-10 të vendimit) kanë një frymë akoma më të avancuar kur parashikojnë se: “Ndërtimet pa leje, për të cilat poseduesit nuk kanë aplikuar për legalizim deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, trajtohen nga ASHK-ja, **kryesisht**, gjatë proceseve të regjistrimit fillestar....apo nëpërmjet procedurës së evidentimit të ndërtimeve pa leje<sup>11</sup>”.

---

<sup>11</sup> Neni 17, pika 2, e ligjit nr. 20/2020.

Në këtë kuadër, ligji ka parashikuar trajtimin e kërkesës, aplikimit të individit në përputhje me përcaktimet e dispozitave të tij, si dhe bazuar në përgjegjësinë institucionale të autoritetit kompetent, ASHK-së.

Por, Ligji ka parashikuar gjithashtu, edhe rastet e trajtimit *kryesisht* nga ana e ASHK-së, të rasteve të ndërtimeve pa leje, edhe kur poseduesit e tyre nuk kanë aplikuar për legalizim deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, pra në vitin 2020, e atëherë duhet të trajtonin rastin e ankueses, kur ajo kishte aplikuar për legalizim banese, që në vitin 2017, pra, para se ky ligj të hynte në fuqi.

Gjithashtu, në mënyrë të shprehur, vetë ligji, në nenin 69, pikën 1 dhe 9, të tij, parashikon se: *“1. Aplikimet për legalizim, të administruara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, që kanë mangësi të elementëve të formës, konsiderohen të vlefshme.*

*...9. Ndërtimet pa leje, që janë përfunduar në strukturë përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, ndonëse nuk evidentohen në ortofoton, sipas pikës 1, të nenit 17, të tij, trajtohen nga ASHKja, sipas rregullave të seksionit I të kreut III, nëse janë: a) objekte, shtesa pa leje në ndërtim të regjistruar, objekte me shkelje të lejes së ndërtimit, me funksion banimi ose në funksion të aktivitetit bujqësor apo blegtoral, ndërtuar në fshat...*

*Rregullat për zbatimin e kësaj pike dhe evidentimin e ndërtimeve pa leje përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”*

Ndërkohë që, VKM nr. 1178/2020 *“Për përcaktimin e dokumentacionit dhe të rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimit pa leje”,* në pikën 12 e 21 të saj, ka përcaktuar se:

*“12. Për ndërtimin pa leje që nuk është aplikuar më parë për legalizim aplikohet, nëpërmjet platformës unike qeveritare e-Albania, kundrejt tarifës së aplikimit prej 3 000 (tre mijë) lekësh.*

*21. Subjektet, që kanë bërë kërkesë për legalizim nga data 07.05.2020 deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi dhe për të cilat nuk është miratuar vendimi për legalizim, duhet të shlyejnë tarifën e aplikimit të parashikuar në pikën 12 të tij.”*

Pra, qartazi, subjekti ankues nuk përfshihet tek subjektet e parashikuara në nenin 12 e 21, të VKM-së sipërcituar, të cilët duhet të shlyejnë tarifën e aplikimit prej 3 000 (tre mijë) lekësh dhe që aplikimin duhet ta bëjnë nëpërmjet platformës online e-Albania, pasi:

- Ankuesja nuk ka aplikuar për herë të parë për legalizim të banesës, ndërtim informal;
- Ankuesja nuk ka paraqitur kërkesën e saj për legalizim gjatë periudhës nga data 07.05.2020 e në vijimësi, pasi aplikimi i saj daton që me 20.11.2017.

Pra, për rrjedhojë, Komsioneri vlerëson se, DV ASHK Shkodër duke e klasifikuar në mënyrë të gabuar ankuesen tek subjektet të cilat duhet të kryejnë aplikimin për legalizim banese, objekt pa leje, në platformën online e-Albania, konform pagesës së faturës së aplikimit prej 3 000 (tre mijë) lekësh, është bërë pengesë për vijimin e mëtejshëm të hapave proceduralë për të vijuar me plotësimin e kërkesave të tjera për legalizimin e banesës së saj, duke konsideruar ai të pavlefshëm aplikimin e paraqitur prej saj në datë 20.11.2017.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, DV ASHK Shkodër, duhet të kishte ndërmarrë hapa konkretë e masat e duhura, duke vepruar edhe kryesisht, për shqyrtimin e kërkesës së ankueses për legalizim banese, objekt pa leje, dhe konsiderimin e vlefshëm të tij, për të vijuar më tej me hapat e tjerë proceduralë. Subjekti ankues nuk ka pse të ngarkohet me barrën e riaplikimit në sistemin online e-Albania, e për më tepër kundrejt faturës në vlerën prej 3 000 (tre mijë) lekësh, kur ajo nuk ka një detyrim të tillë ligjor.

Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se, nga ana e DV ASHK Shkodër nuk janë bërë përpjekjet e veprimet e duhura, për të përmbushur kërkesën e ankueses, nga ana e tyre, por edhe detyrën funksionale për të cilën ky organ është krijuar dhe funksionon në përputhshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

Nga analizimi i dispozitave ligjore sipërcituar, si dhe referuar ngjarjeve e fakteve, objekt hetimi, rezulton qartazi se, DV ASHK Shkodër, ka trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme, subjektin ankues, përse i takon mosshqyrtimit të kërkesës së saj për legalizim objekti informal.

## **B. Shkaku i mbrojtur**

Mbështetur në nenin 2<sup>12</sup>, të ligjit nr. 10 221, date 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

### **B. 1 Raca**

Referuar nenit 1, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, shkaku i poseduar nga subjekti ankues, konsiderohet si shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si

---

<sup>12</sup>“Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b)barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga cdo forme sjelljeje qe nxit diskriminim.”

i tillë në LMD, si dhe subjekti ankues ka depozituar provën shkresore e cila fakton se e mbart atë.

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1, si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ligji ka bërë në nenin 3, të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*, të ndryshuar, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme dhe të padrejta që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit.

Nocioni “racë” i ka rrënjët në idenë e klasifikimit biologjik të qenieve njerëzore në nën-specie sipas tipareve morfologjike, si ngjyra e lëkurës apo karakteristikat e fytyrës. Dokumentet ligjore të BE-së dhe ato ndërkombëtare përdorin nocionin e diskriminimit racor ndërkohë që kundërshtojnë në mënyrë eksplicite nocionin e racave të veçanta njerëzore. Ndalimi i diskriminimit në bazë të origjinës racore ose etnike mund të mbulojë gjithashtu diskriminimin bazuar në ngjyrën, prejardhjen ose origjinën kombëtare. Ky shkak lidhet shpesh edhe me shkakun tjetër të parashikuar që është ai i ngjyrës. Në Shqipëri, diskriminimi për shkak të racës është lidhur kryesisht me pakicat kombëtare rome dhe egjiptiane<sup>13</sup>.

Përkufizimi më gjerësisht i pranuar mbi racën është ai i Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e Gjithë Formave të Diskriminimit Racor. Në nenin 1, kjo Konventë, përkufizon diskriminimin racor si çdo dallim, përjashtim ose privilegjim në bazë të racës, ngjyrës së lëkurës, origjinës ose origjinës nacionale ose etnike, që ka për qëllim pamundësimin ose vështirësimin të pranimit, gëzimit apo ushtrimit të bazës së barabartë të të drejtave dhe lirive bazë të njeriut në fushën e jetës ekonomike, shoqërore, kulturore, si dhe fusha tjera të jetës publike<sup>14</sup>. Në kontekstin rajonal evropian, me rëndësi është përkufizimi i Komisionit Evropian kundër racizmit dhe tolerancës (ECRI), sipas së cilit, racizmi dhe diskriminimi racor lidhen me bazat racë, ngjyrë të lëkurës, fe, nacionalitet ose origjinë nacionale ose etnike<sup>15</sup>.

Përkatësia etnike shpesh konsiderohet si pjesë e diskriminimit racor. Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (KDESK) konsideron përkatësinë etnike si shkak të mbrojtur për diskriminim, dhe si pjesë të mbrojtjes nga diskriminimi në bazë të racës dhe ngjyrës së lëkurës<sup>16</sup>. Sipas GjEDN-së, përkatësia etnike nxjerr origjinën nga idea mbi grupet shoqërore, tipari kryesor i të cilave është origjina e përbashkët nacionale, lidhshmëria me një

<sup>13</sup> <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>

<sup>14</sup> Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor. Neni 1

<sup>15</sup> ECRI General policy recommendation No. 7 on national legislation to combat racism and racial discrimination. *Council of Europe Website*.

<[http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/ecri/activities/gpr/en/recommendation\\_n7/ecri03-8%20recommendation%20nr%207.pdf](http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/ecri/activities/gpr/en/recommendation_n7/ecri03-8%20recommendation%20nr%207.pdf)>.

<sup>16</sup> Komenti i përgjithshëm nr. 20 i Komitetit për të Drejta Ekonomike, Sociale dhe Kulturore. paragrafi 19

fis të caktuar (ang. tribe), bindje fetare, gjuhë të përbashkët, ose origjinë dhe prapavijë kulturore dhe tradicionale<sup>17</sup>.

GJEDNJ-ja në çështjen Timishev kundër Ruisë , ka mbajtur qëndrimin se: *“Përkatësia etnike dhe raca janë koncepte të lidhura dhe të mbivendosura. Megjithëse nocioni i racës është i rrënjësor në idenë e klasifikimit biologjik të qenieve njerëzore në nënspecie sipas karakteristikave morfologjike të tilla si ngjyra e lëkurës apo karakteristikat e fytyrës, përkatësia etnike e ka origjinën e vet në idenë e grupeve shoqërore të shënuar nga kombësia e përbashkët, përkatësia fisnore, besimi fetar, gjuha e përbashkët, ose origjina dhe prejardhja kulturore dhe tradicionale<sup>18</sup>”*

Ligji nr. 97/2017 *“Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë”*, në nenin 6<sup>19</sup>, të tij, sanksionon se: *“Çdo person ka të drejtë të deklarojë përkatësinë në një pakicë kombëtare, bazuar në të drejtën e vetidentifikimit, sipas parashikimeve të legjislacionit për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë së Republikës së Shqipërisë dhe në rastet e parashikuara në këtë ligj.”*

Referuar Deklaratës të datës 21.08.2023, evidentohet fakti se ankuesja i përket pakicës kombëtare egjiptiane dhe se është banore e lagjes “Liria”, njohur si lagje e populluar nga kjo pakicë kombëtare, pohim ky i cili është faktuar edhe në të paktën dy raste të tjera të trajtuara kryesisht nga KMD-ja<sup>20</sup>, ku ndër të tjera, Komisioneri citon se:

*“Referuar informacionit të përcjellë nga ERRC, sikurse edhe nga DAR Shkodër, Bashkia Shkodër dhe Shkolla 9-vjeçare “Liria”, rezulton se kjo e fundit e ka vendndodhjen në Lagjen Liria, e cila ndodhet pranë vendbanimit të hershëm të familjeve egjiptiane në hyrje të qytetit të Shkodrës, pra në një lagje që popullohet nga familje egjiptiane të këtij qyteti, si dhe nga familje romë të ardhura nga qytete të tjera.”*

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson të provuar shkakun e pretenduar të diskriminimit, atë të racës, si pjesë e pakicës kombëtare egjiptiane.

### **C. Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm të ankueses nga DV ASHK Shkodër, me racën si shkak i mbrojtur**

Për të vërtetuar faktin se ankuesja është ekspozuar ndaj një sjellje diskriminuese nga ana e DV ASHK Shkodër, duhet të ekzistojë një lidhje objektive shkakësore ndërmjet shkakut të

<sup>17</sup> Timishev v Russia (2007) 44 EHRR 776. para.55

<sup>18</sup> GJEDNJ, *Timishev kundër Ruisë* (Numrat 55762/00 dhe 55974/00), 13 Dhjetor 2005, paragraf 55 (ECtHR, *Timishev v. Russia* (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005, para. 55).

<sup>19</sup> E drejta e vetidentifikimit

<sup>20</sup> Për analogji citojmë Vendimin nr. 58, datë 08.05.2029, lidhur me çështjen e segregimit të nxënësve romë dhe egjiptianë në qytetin e Shkodrës dhe specifikisht në Shkollën 9-vjeçare “Liria”, dhe Vendimin nr. 164, datë 13.11.2019, lidhur me përdorimin e terminologjisë së papërshtatshme për etiketimin e lagjes “Iliria” Shkodër, si lagjja e “Magjypëve”, nga ana e një prej institucioneve shtetërore.

mbrojtur nga ligji 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe trajtimit të padrejtë e të pafavorshëm të ankueses, në raport me të drejtat ligjore të saj.

Shqipëria i përmbush instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe e ka zhvilluar kuadrin e saj ligjor në përputhje me standardet evropiane. Brenda këtij konteksti, Shqipëria ka zhvilluar një kuadër ligjor dhe nënligjor të përparuar që adreson çështjet e minoriteteve rome dhe egjiptiane bazuar në standartet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislativonin shqiptar, si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Neni 18, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku sanksionohet ky parim parashikon : “1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive.”.

Në nenin 59, pika 1, germa b), të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcaktohet shprehimisht detyrimi i shtetit shqiptar për plotësimin e nevojave të shtetasve të tij, për strehim. Kështu, në këtë dispozitë parashikohet se: “1. Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon: .....b) plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim”.

Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka mbajtur qëndrimin se, parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t’i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në respektim të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal të tyre, ashtu edhe atë material. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor<sup>21</sup>.

Me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e drejta ndërkombëtare që rrjedh nga marrëveshjet ndërkombëtare (e njohur ndryshe edhe si “e drejta konventore”) ka një vend të posaçëm.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Po ashtu, kjo dispozitë kushtetuese duhet lexuar në harmoni edhe me nenin 122, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, ku sanksionohet se:

---

<sup>21</sup> Citojmë këtu, Vendimet e Gjykatës Kushtetuese me: nr. 2, datë 03.02.2010, nr.1, datë 12.01.2011, nr. 23, datë 08.06.2011.



*“1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji...*

*2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të...*

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njih dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), në nenin 14 të saj, ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë joshteruese shkaqesh. Ndërkohë Protokollit 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me *“gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji”* dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur subjekti është diskriminuar:

*“a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë;*

*b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm;*

*c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare;*

*d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.*

Mbrojtja nga diskriminimi në sferën e aksesit tek mallrat dhe shërbimet, duke përfshirë strehimin, zbatohet edhe në rastin e racës nëpërmjet Direktivës për Barazinë Raciale, miratuar në vitin 2000 nga organet ligjvënëse të BE-së. Direktiva në fjalë ndalon diskriminimin për shkak të racës ose etnisë në kontekstin e punësimit, por gjithashtu ka parashikime në përfshirjen tek sistemi i ndihmës sociale dhe sigurimeve shoqërore, si dhe mallrat dhe shërbimet. Direktiva për Barazinë Raciale nuk jep një përkufizim të termit “strehim”, por pavarësisht kësaj, sugjeron se dispozitat e saj duhet të interpretohet në dritën e të drejtave ndërkombëtare të njeriut, në veçanti të drejtës për respektimin e shtëpisë (sipas nenit 7 të Kartës së BE-së për të Drejtat Themelore dhe Nenit 8 të KEDNJ-së), dhe të drejtës për strehim të përshtatshëm (sipas nenit 11 të Marrëveshjes Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike dhe Social Kulturore).

Në përputhje me Nenin 11(1) të Komentit të Përgjithshëm Nr.4: E drejta për strehim të mjaftueshëm e Komitetin Evropian për të Drejtat Ekonomike Social Kulturore (KEDS),

strehimi i përshtatshëm duhet të plotësojë një sërë kriteresh, dhe në veçanti duhet të përfshijë gjithashtu mbrojtjen efektive nga organet përgjegjëse kombëtare.

Në çështjen European Roma Rights Centre (ERRC) kundër Portugalisë, KEDS-ja ka vërtetuar ekzistencën e diskriminimit në lidhje me të drejtën e mbrojtjes sociale, juridike dhe ekonomike të familjeve, të drejtën e mbrojtjes nga varfëria dhe përjashtimit social dhe të drejtën e banimit përkatës (n. 16, 30 dhe 31 nga MSE-ja)<sup>22</sup>

Raporti i ECRI-i për Shqipërinë<sup>23</sup>, i datës 7 prill 2020, përsërit rekomandimin e tij që, autoritetet përgjegjëse shtetërore duhet të sigurojnë që të gjithë romët dhe egjiptianët, si çdo person tjetër, të gëzojnë të gjitha garancitë që parashikojnë aktet ligjore ndërkombëtare në lidhje me strehimin. Në veçanti, shtesat vulnerabël duhet të përfitojnë nga mbrojtja e duhur ligjore dhe të kenë mundësinë e strehimit në një banesë të përshtatshme.

Raporti i sipërcituar në pikat 53-54, të tij përcakton se: *“Situata e strehimit është ende jashtëzakonisht e vështirë për shumë romë dhe egjiptianë në Shqipëri. Përveç kushteve shpesh shumë të dobëta, mungesa e përhapur e titujve të pronësisë ose marrëveshjeve të sigurta të qiramarrjes i bën shumë anëtarë të këtij komuniteti të prekshëm nga dëbimet. Merrritjen e zhvillimit ekonomik në Shqipëri, romët dhe egjiptianët që jetojnë në banesa joformale kanë qenë nën presion për t'i braktisur vendbanimet e tyre, në disa raste duke u dëbuar shumë herë nga vende të ndryshme, pa qasje të lehtë në zgjidhje alternative dhe të përhershme të strehimit. Duke pasur parasysh që kërkesa e përgjithshme për strehim social në vend tejkalon ofertën, kjo zakonisht nuk është një zgjidhje e menjëhershme, përveç një numri të vogël të personave të prekur. Sidoqoftë, shumë romë dhe egjiptianë preferojnë, ose edhe insistojnë, të qëndrojnë së bashku në grupet e tyre të krijuara, të cilat jo vetëm që përbëjnë një identitet kulturor për ta, por janë edhe rrjete të rëndësishme mbështetëse për të përballuar më mirë varfërinë dhe efektet e marginalizimit shoqëror. Në raportin e tij të mëparshëm, ECRI rekomandoi që: (i) autoritetet të forcojnë përpjekjet e tyre për të rregulluar strehimin e paligjshëm për romët dhe egjiptianët... (iii) akses me përparësi për strehim social, duke u reformuar në mënyrë që të përfshijë më mirë personat e prekur nga prishja e banesave/dëbimeve”.*

Referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, Gjykata, në qëndrimet e saj ka qenë jashtëzakonisht e rreptë në lidhje me diskriminimin për shkak të racës ose përkatësisë etnike duke u shprehur se: *“Asnjë diferencë në trajtim, që bazohet ekskluzivisht ose në një masë vendimtare tek përkatësia etnike e një personi nuk mund të përliqjet objektivisht në një shoqëri demokratike bashkëkohore, të ndërtuar në parimet e pluralizmit dhe respektit për kulturat e ndryshme”.* Detyrimi ligjor i organeve shtetërore dhe e drejta për të përfituar nga parashikimet e mësipërme ligjore, për kategorinë e individëve që i përkasin minoriteteve të caktuara (për shkak të etnisë dhe racës së tyre) të cilët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes sociale, ekonomike,

<sup>22</sup> Komiteti kishte vlerësuar se kishte munguar reagimi përkatës i shtetit, dhe se ekziston diskriminimi që ka si bazë përkatësinë etnike. Një gjykim të këtillë Komiteti kishte sjellë dhe në rastin COHRE kundër Italisë

<sup>23</sup> <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2020/07/Raporti-i-ECRI-t-për-Shqipërinë.pdf>

*juridike, etj, sanksionohet dhe në aktet ligjore e nënligjore kombëtare, në të njëjtën frymë si në aktet ndërkombëtare sipërcituar.”*

Në nenin 10, të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar, gjen parashikim edhe parimi i mosdiskriminimit. Në këtë nen parashikohet shprehimisht se: “1. Të drejtat që burojnë nga ky ligj i garantohen pa asnjë lloj diskriminimi çdo individ, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, feja, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale, shtatzënia, përkatësia ose/dhe përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo gjendje që sjell pasoja diskriminuese.”

Duke filluar nga tetori i vitit 2017, si romët ashtu edhe egjiptianët janë njohur si pakica kombëtare në Republikën e Shqipërisë. Në mënyrë eksplicite, ligji nr. 97/2017 “Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, sanksionon ndër të tjera, mbrojtjen e pakicave kombëtare nga diskriminimi (neni 8)103.

Në nenin 8 të tij, pika 2, ligji nr. 97/2017, ngarkon institucionet publike, qendrore dhe vendore, me përgjegjësi për të miratuar dhe zbatuar masa për të: - garantuar barazi të plotë dhe efektive në jetën ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore ndërmjet personave që i përkasin një pakice kombëtare dhe atyre që i përkasin shumicës.

Në kuadër të procesit të integritit të Shqipërisë në BE, Qeveria Shqiptare ka miratuar disa dokumenta, siç janë Plani Kombëtar i Integritit European dhe Udhërrëfyeni për plotësimin e 5 Prioriteteve, që përcaktojnë masa konkrete për realizimin e këtij procesi. Pesë prioritetet kyçe që rezultojnë nga dialogu politik i nivelit të lartë midis qeverisë dhe BE-së përfshijnë, “masa efikase për forcimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, duke përfshirë romët dhe politikat antidiskriminuese”.

Përmbushja e Prioritetit 5 në Udhërrëfyenin e Qeverisë, orienton marrjen e masave në shumë fusha të politikave specifike për Romët/Egjiptianët si: regjistrimi civil, aksesin në drejtësi, arsimin, dialogun ndërkulturor, punësimin dhe përmirësimin e aftësive, kujdesin shëndetësor, strehimin dhe integritin urban dhe mbrojtja sociale. Janë pikërisht këto fusha që kanë orientuar objektivat kryesore të përcaktuara në këtë dokument.

Gjithashtu duke marrë parasysh angazhimet e përshekruara në dokumentin Udhërrëfyeni Plani i Veprimit jep një listë më të detajuar të aktiviteteve që do të zbatoheshin. Ndër të tjera, Plani i Veprimit trajton nevojat në një sërë fushash kyçe përfshirë: arsimin dhe promovimin e dialogut ndërkulturor, shëndetësinë, strehimin dhe integritin urban, punësimin dhe arsimin e aftësimin profesional, mbrojtjen sociale, regjistrimin civil dhe aksesin në sistemin e drejtësisë, me synim nxitjen e integritit në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

Në Planin Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve (PKVBPPR) në Republikën e Shqipërisë (2021-2025), sikurse edhe PKVBPPR

paraardhës (2016-2020), parashikohet marrja e masave të nevojshme nga ana e shtetit shqiptar lidhur me çështjen e strehimit të pakicës kombëtare romë dhe egjiptiane.

Në pikën 3/7 “Parimet Themelore”/ “Promovimi i lidhjeve ndërsektoriale” – Plani i Veprimit (2021-2025) trajton nevojat për këto pakica kombëtare në një sërë fushash kyçe, duke përfshirë: arsimin dhe promovimin e dialogut ndërkulturor, shëndetësinë, strehimin dhe integrimi urban, punësimin dhe arsimin e aftësimin profesional, mbrojtjen sociale dhe regjistrimin civil dhe aksesin në sistemin e drejtësisë, me synim nxitjen e integritit në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

Në Rubrikën 4 “Kushtet Aktuale dhe Sfidat”, të këtij Plani<sup>24</sup> citohet se: *“Situata e strehimit është ende e vështirë për shumë anëtarë të minoritetit Rom dhe Egjiptianë në Shqipëri. Përveç kushteve shpesh shumë të rrënuara, mungesa e titujve të pronësisë ose marrëveshjeve të sigurta të qiramarrjes i bën shumë anëtarë të këtij komuniteti të prekshëm nga dëbimet. Shumë njerëz ngritën banesat e tyre në tokë publike të papërdorur edhe në pronë, pronësia e së cilës mbetet e paqartë pas rënies së komunizmit në fillim të viteve 1990.”*

Në Pjesën II – Qëllimet e Politikave dhe Objektivat Specifikë/ Qëllimet Strategjike të PKVBPPE 2021-2025, pika 2, të Planit të Veprimit (2021-2025) parashikohet se një ndër qëllimet strategjike më të rëndësishëm të këtij plani është edhe përmirësimi i kushteve të strehimit për anëtarë të Minoriteteve Rome dhe Egjiptiane si dhe legalizimi i të gjitha vendbanimeve jo formale.

Objekti Specifik 1, i këtij qëllimi strategjik përcakton shprehimisht rritjen e numrit të përfituesve romë dhe egjiptianë nga çdo program strehimi. Në elaborimin që i bëhet këtij objekti citohet: *“Anëtarë të komunitetit Rome dhe Egjiptianë vazhdojnë ende të përballen me vështirësi për sa i takon çështjeve të strehimit. Këtu përfshihen vështirësitë në aplikimin për strehim social. Në më të shumtën e rasteve ka mungesa në burimin e verifikueshëm të të ardhurave dhe dokumenteve të tjera si dhe procedurat janë të ndërlikuara. Kjo situatë e vështirë shoqërohet edhe me mungesën e strehëve të përkohshme (si, Qendra Kombëtare Tranzitore e Emergjencave) dhe mungesës së alternativave afatgjata dhe e zgjidhjeve të qëndrueshme të strehimit për këto komunitete. Mbështetja me ndihmë ligjore falas për anëtarët e Minoritetit Rom dhe Egjiptian për problemet që ata mund të hasin gjatë procesit të përfundimit të legalizimit është domosdoshmëri. Shumë familje romë dhe egjiptiane jetojnë në objekte të paprivatizuara ende si: ish-ndërmarrje, pulari, pallate etj, ose i kanë nisur procedurat dhe nuk i kanë përfunduar ato, pra nuk zotërojnë titujt e pronësisë së vendbanimit...”*

Objekti specifik 2. Miratimi i kuadrit ligjor dhe bashkëpunimi midis institucioneve në nivel qendror dhe vendor për adresimin e nevojave për legalizimin dhe strehimin social, parashikon se:

*“ Legalizimi i banesave ekzistuese të anëtarëve të pakicave romë dhe egjiptiane kërkon ndjekjen e një procedure të ndërlikuar. Për rrjedhojë lind nevoja për ofrimin e asistencës*

<sup>24</sup> Referuar faqes 12, të Planin Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve & Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë (2021-2025);

teknike në ndjekjen e procedurave të legalizimit. Pagesa e truallit dhe kostove të tjera që implikohen me legalizimin janë të papërballueshme për shumë familje romë dhe egjiptiane. Këtë e vështirëson edhe më shumë mungesa e ndërjegjësisimit dhe e kapacitetit për ndjekjen e procedurave të legalizimit nga antëtarët e të dy komuniteteve. Rikonstruksioni i banesave ekzistuese të romëve është i pamundur nëse janë ndërtuar në mënyrë të paligjshme përfshirë këtu edhe mungesën e financimit në nivel vendor. Përmirësimi i infrastrukturës në zona të banuara nga romët dhe egjiptianët është ndonjëherë i mundur, por i kushtueshëm për t'u trajtuar vetëm nga vetëqeveritë vendore.

Plani i ri i veprimit parashikon investime infrastrukturore në zonat ku jeton pjesa më e madhe e romëve dhe egjiptianeve përfshirë këtu: rregullimin e rrugëve, kanalizimeve, ujësjellësit, ndricimi dhe rikonstruksion banesash. Aktualisht shumica e banesave informale të romëve shkatërrohen për të mundur realizimin e projekteve të punëve publike dhe familjet e prekura nuk përfitojnë asnjë kompensim ose kompensim të papërshtatshëm.

Prishja e këtyre banesave shpesh nuk kryhet në bashkëpunim me autoritetet e mbrojtjes sociale dhe familjeve të prekura nuk u ofrohet asnjë mundësi strehimi, p.sh. bonus për qiranë, truall i pajisur me infrastrukturë, kredi me kushte lehtësuese ose sistemin në banesa sociale.

Plani i ri parashikon miratimin e aktit nënligjor në zbatim të pikës 2, neni 33 i ligjit 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

Ky akt do të përcaktojë mënyrat e trajtimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit financiar, format alternative të trajtimit si dhe rregullat dhe afatet për realizimin e tyre. Përfitues janë të gjithë poseduesit e ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen dhe që trajtohen nga shteti nëpërmjet shpërblimit financiar, programeve sociale të trehimit ose formave alternative të trajtimit. Ka një mungesë të koordinimit dhe bashkërendimit të veprimeve midis institucioneve vendore dhe qendrore...”

Komenti i Përgjithshëm nr. 20 “Mosdiskriminimi në të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore”, i Komitetit për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, i Kombeve të Bashkuara parashikon: “Situata sociale dhe ekonomike e një personi kur jeton në varfëri ose është i pastrehë mund të rezultojë në diskriminim të përhapur, stigmatizim dhe stereotipe negative që mund të çojnë në refuzimin ose aksesin e pabarabartë për të njëjtën cilësi të arsimit dhe kujdesit shëndetësor si të tjerët, si dhe mohim ose akses të pabarabartë në vendet publike”.

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si: çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Me 6 qershor 2023, Komiteti Këshillimor për Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (KKMK) ka miratuar opinionin e tij të pestë për Shqipërinë<sup>25</sup>, ku, ndër të tjera citon se:

<sup>25</sup> <https://rm.coe.int/5th-op-albania-summary-al/1680acf90f>

*“Kushtet e banimit për pakicat rome dhe egjiptiane janë gjithashtu shqetësuese, duke përfshirë ndarjen dhe diskriminimin në tregun privat të qirave, statusin e parregullt të pronës dhe kërcënimin e dëbimeve me forcë. Siguria e banesave duke pasur parasysh në veçanti kërcënimet mjedisore ngre shqetësime serioze...”*

KKMK, në rekomandimet për veprim të menjëhershëm për autoritetet shqiptare, ndër të tjera: “19 ...u kërkon autoriteteve të sigurojnë qasje në strehim të mjaftueshëm për romët, veçanërisht përmes sigurimit të investimeve për garantimin e aksesit në ujë të pijshëm dhe energji elektrike në zonat ku jetojnë romët. Autoritetet duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë garantimit të kushteve të sigurta të jetesës, gjithashtu duke pasur parasysh rreziqet që vijnë nga ndotja e mjedisit dhe ndryshimet klimatike, si dhe sigurisë ligjore të kohëqëndrimit. Në këtë kontekst, rregullimi i pronësisë të pronave që zotërohen ose janë të banuara nga persona që i përkasin pakicave rome dhe egjiptiane është veçanërisht i rëndësishëm. Autoritetet publike të interesuara duhet të respektojnë detyrimet për të raportuar çdo dëbim të planifikuar pranë Avokatit të Popullit dhe për të ofruar strehim të përshtatshëm alternativ, dhe nëse këto detyrime nuk përmbushen duhet të zbatohen sanksione.

20. Komiteti Këshillimor u bën thirrje autoriteteve të zhvillojnë mënyra dhe mjete për të mbledhur të dhëna për barazinë në lidhje me personat që u përkasin pakicave kombëtare, veçanërisht pakicat rome dhe egjiptiane, dhe veçanërisht në fushën e arsimit, strehimit, punësimit dhe kujdesit shëndetësor...”

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.

Neni 20/1 i LMD-së, përcakton qartë detyrimin e personave fizik ose juridik që ofrojnë të mira apo shërbime për publikun, duke cituar shprehimisht:

*“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”*

Bazuar në nenin 82/2 të Kodit të Procedurave Administrative barra e provës në çështjet e diskriminimit është objekt i një rregullimi të posaçëm: “Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se

*faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.*

Në të njëjtën frymë është dhe ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, i cili, në nenin 33, pikën 7/1 të tij, ka përcaktuar se: “Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë të kundërtën.

Sa më sipër, “subjekti ankues” duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjektet kundër të cilëve është drejtuar ankesa, të cilët duhet të tregojnë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

- Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
- Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojnë njëherë nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.<sup>26</sup>

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar, është shkak i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet, kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër.

Pra, nëse faktet e prezantuara nga ankuesi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës. GJEDNJ pranon si fakte ato vlerësime “*të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave....provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër, niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht*”<sup>27</sup>.

<sup>26</sup> [https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra\\_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018\\_en.pdf](https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf), fq.232.

<sup>27</sup> GJEDNJ, Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë (GC) paragrafi 147, (ECtHR, Nachova and others v. Bulgaria [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005). Kjo përsëritet në çështjen e GJEDNJ-së, Timishev kundër Rusisë (Numrat 55762/00 dhe 55974/00), 13 Dhjetor 2005, paragrafi 39 (ECtHR, Timishev v. Russia (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005), dhe GJEDNJ, D.H dhe të tjerët kundër Republikës Çeke

Për sa më sipër, mbështetur në provat dhe faktet e administruara, KMD vlerësoi se jemi para situatës së prezumimit të diskriminimit nga DV ASHK Shkodër, kundrejt subjektit ankues, që i përket pakicës egjiptiane, banore e lagjes “Liria” dhe si pasojë barra e provës bie mbi këtë subjekt.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga subjekti ankues, *së pari*, Komisioneri ka vlerësuar dhe ka arritur në përfundimin se ajo i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e DV ASHK Shkodër.

*Së dyti*, Komisioneri, do të vlerësojë nëse ky trajtim i padrejtë, i pafavorshëm i subjektit ankues, nga ana e DV ASHK-së, lidhet me shkakun e mbrojtur.

Mbështetur në faktet dhe provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, si dhe analizimit të legjislacionit përkatës<sup>28</sup>, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm nga ana e DV ASHK Shkodër, në raport me të drejtën e saj ligjore, lidhur me kërkesën e saj për legalizim objekti pa leje, dorëzuar më datë 20.11.2017, sa më sipër analizuar.

Subjekti ankues ka pretenduar se është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, nga ana e DV ASHK-së, përmes moshqyrtimit të aplikimit për legalizim banese, të bërë prej saj në vitin 2017 dhe kërkesës për të riaplikuar sërish kundrejt tarifës prej 3 000 (tre mijë) lekësh në sistemin online e-Albania, me qëllim përfshirjen e aplikimit në sistem.

Posedimi i shkakut të mbrojtur nga ana e subjektit ankues, rezulton i njohur dhe i pakundërshtuar nga ana e DV ASHK-së, për faktin se ankuesja banon në një lagje të njohur nga komuniteti i qytetit të Shkodrës, si lagje ku banojnë anëtarë të pakicës kombëtare egjiptiane dhe rome, por edhe për faktin se nga ana e KMD-së i është bërë e ditur që ankuesja ka pretenduar diskriminim pikërisht për shkak të racës së saj.

Komisioneri vlerëson se nga informacionet e dërguara nga ana e DV ASHK Shkodër, në asnjë rast nuk u arrit të provohej:

- Që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të pretenduar nga subjekti ankues, që është raca dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë nga ana e DV ASHK-së, të konstatuar edhe nga Komisioneri në këtë vendim.
- Që për veprimet dhe mosveprimet e këtij subjekti kundrejt ankueses janë në përputhje me parashikimet ligjore, të drejta dhe të arsyeshme.

Për rrjedhojë, Komisioneri gjykon se, DV ASHK Shkodër ka keqinterpretuar klasifikimin që i bën aplikimit të ankueses, duke mos ia shqyrtuar kërkesën e paraqitur në vitin 2017, dhe duke e konsideruar atë si ankesë të re, për të cilën duhet aplikuar në sistemin online të e-Albania, kundrejt faturës prej 3 000 (tre mijë) lekësh.

---

[GC] (Nr. 57325/00), 13 Nëntor 2007, paragrafi 178 (ECtHR, D.H. and others v. the Czech Republic [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007).

<sup>28</sup> Shih Ndarjen III, nëndarja A.1, të vendimit të KMD.

Adresa: Rruga “Durrësit”, Nr. 27, Kodë Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al), Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)



Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues nuk përfshihet tek subjektet e parashikuara në nenin 12 e 21, të VKM-së nr. 1178/2020 “Për përcaktimin e dokumentacionit dhe të rregullave të hollësishtme të evidentimit të ndërtimit pa leje”, të cilët duhet të shlyejnë tarifën e aplikimit prej 3 000 (tre mijë) lekësh dhe që aplikimin duhet ta bëjnë nëpërmjet platformës online e-Albania, pasi:

- Ankuesja nuk ka aplikuar për herë të parë për legalizim të banesës, ndërtim informal;
- Ankuesja nuk ka paraqitur kërkesën e saj për legalizim gjatë periudhës nga data 07.05.2020 deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, pasi aplikimi i saj daton që me 20.11.2017.
- DV SHK Shkodër nuk ka ndërmarrë asnjë hap për trajtimin e kërkesës së z. B, që nga momenti i aplikimit fillestar e në vijimësi.

Pra, për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson se, DV ASHK Shkodër duke e klasifikuar në mënyrë të gabuar ankuesen tek subjektet të cilat duhet të kryejnë aplikimin për legalizim banese, objekt pa leje, në platformën online e-Albania konform pagesës së faturës së aplikimit prej 3 000 (tre mijë) lekësh, është bërë pengesë për vijimin e mëtejshëm të hapave proceduralë për të vijuar me plotësimin e kërkesave të tjera për legalizimin e banesës së saj, duke konsideruar ai të pavlefshëm aplikimin e paraqitur prej saj në datë 20.11.2017. Subjekti ankues nuk ka pse të ngarkohet me barrën e riaplikimit në sistemin online e-Albania, e për më tepër kundrejt faturës në vlerën prej 3 000 (tre mijë) lekësh, kur ajo nuk ka një detyrim të tillë ligjor.

Pavarësisht njohjes nga ana e subjekteve shtetërore të faktit se anëtarët e pakicave kombëtare rome e egjiptiane kanë hasur ndër vite dhe vazhdojnë të hasin problematika e vështirësi të ndryshme lidhur me iniciimin apo përfundimin e procedurave për njohjen e titujve të pronësisë për banesat e tyre informale, Komisioneri vlerëson se, nga ana e DV ASHK Shkodër nuk janë bërë përpjekjet e veprimet e duhura, për të përmbushur kërkesën e ankueses, nga ana e tyre, (as kryesisht) por edhe detyrën funksionale për të cilën ky organ është krijuar dhe funksionon në përputhshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 3, pika 6, i LMD-së, përcakton se: “*“Diskriminim strukturor” është ajo formë diskriminimi që u referohet rregullave, normave, praktikave, modeleve të qëndrimeve dhe sjelljeve në institucione dhe në struktura të tjera shoqërore, që në mënyrë të vetëdijshme ose të pavetëdijshme paraqesin pengesa për grupet ose individët për të pasur të njëjta të drejta dhe mundësi si të tjerët dhe që kontribuojnë në rezultate më pak të favorshme për ta në raport me të tjerët.*”

Lidhur me përkufizimin për *diskriminimin strukturor* dhe trajtimin që i bëhet kësaj forme të diskriminimit, sipas Këshillit të Evropës<sup>29</sup>, në materialet e publikuara prej tij, citohet se:

---

<sup>29</sup> Aksesohet linkun:

<https://www.coe.int/sq/web/interculturalcities/systemic-discrimination>,  
dhe <https://www.seesac.org/f/docs/Gender-and-Security/UNDP---Gender-Equality-in-the-Military---Handbook-ALB.pdf>.

Diskriminimi sistemik apo ndryshe i quajtur *diskriminimi strukturor* përfshin procedurat, rutinat dhe kulturën organizative të institucioneve që, shpesh pa qëllim, kontribuon në rezultate më pak të favorshme për grupet minoritare sesa për shumicën e popullsisë, nga politikat, programet, punësimi dhe shërbimet e ndryshme institucionale.

*Diskriminimi strukturor* priret të mos jetë një çështje e veprimit të qëllimshëm. Ai është i rrënjësor në mënyrën se si institucionet ushtrojnë veprimtarinë e tyre të përditshme, si politikëbërës, punëdhënës ose ofrues shërbimesh. Ai është produkt i sistemeve, strukturave dhe kulturave që institucionet shtetërore kanë zhvilluar dhe zbatuar në punën e tyre. *Diskriminimi strukturor, sistemik* mund të veprojë në spektrin e: punësimit, të ardhurave, arsimit, shëndetësisë, strehimit, kulturës, policisë, infrastrukturës publike dhe më gjerë.

Diskriminimi strukturor (sistemik), perceptohet si diskriminimi i grupeve të caktuara për sa i përket qasjes në të drejtat dhe burimet e shoqërisë/komunitetit. Anëtarët e grupeve të diskriminuara në mënyrë sistematike kanë zyrtarisht të gjitha të drejtat, por ka pengesa shoqërore që i pengojnë ata të gëzojnë të drejtat e tyre në të njëjtin nivel me të tjerët. Si rezultat, statusi i tyre shoqëror është më i pafavorshëm, ata janë të përjashtuar nga shoqëria dhe nuk janë në gjendje të marrin pjesë plotësisht në jetën ekonomike, sociale dhe kulturore të shoqërisë/komunitetit.

Diskriminimi strukturor prodhon pabarazi sistematike. Prandaj, përgjegjësia për diskriminimin strukturor nuk është individuale, por i takon kryesisht shtetit dhe institucioneve të tij, në këtë rast, DV ASHK Shkodër.

Për rrjedhojë, nga analizimi i dispozitave ligjore sipërcituar, si dhe referuar ngjarjeve e fakteve, objekt hetimi, rezulton qartazi se, DV ASHK Shkodër, ka trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme, subjektin ankues, për sa i takon mosshqyrtimit të kërkesës së saj për legalizim banese, duke sjellë për pasojë diskriminimin e saj për shkak të racës.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të Ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, përcaktohet se: “*Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre*”, ndërsa bazuar në nenin 33, pika 12, të Ligjit “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, të ndryshuar, përcaktohet: “*Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës*”.

Ligji “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktima të diskriminimit.

Ligji “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, nëpërmjet nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson si masë të duhur për rregullimin e situatës, marrjen e masave të menjëhershme nga DV ASHK Shkodër, si institucioni përgjegjës, për shqyrtimin e kërkesës së ankueses për legalizim banese, objekt pa leje.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 1, nenin 3, nenin 7, pika 1, nenet 11-13, nenin 20, pika 1, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a) e nenin 33, pikat 10-11, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e diskriminimit në formën e *diskriminimit strukturor*, të subjektit ankues, D. B, për shkak të racës, si pjesë e pakicës kombëtare egjiptiane, në fushën e të mirave dhe shërbimeve, nga ana e DV ASHK Shkodër, lidhur me mosshqyrtimin e kërkesës së saj për legalizim të banesës.
2. Referuar pikës 1, të këtij Vendimi, të merren masa nga DV ASHK Shkodër, për shqyrtimin e kërkesës, aplikimit me nr. 1190 prot., datë 20.11.2017, të subjektit ankues D. B, për legalizim banese.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, DV ASHK Shkodër, brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**